



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
31.10.2025

Me datë 31.10.2025, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Bledianë Nika, Uarda Gjekaj, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Ardit Taflaj, Hedije Nasa, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Gjovalin Ndoj, Aleksander Pashuku, Elmira Ndrevasaj, Irena Shala, Izmira Rusi, Irma Kopliku, Artan Haxhi, Elis Doci, Eliona Shkrela, Ardit Behri, Glorja Shllaku, Imeldi Sokoli, Blendi Gjylbegaj, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Marina Duhani, Vjoleta Perndrecaj, Ardita Spahija, Samed Bushati, Suada Kopshti, Fatmir Vojvoda, Plarent Anamali, Muharrem Shkjau.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shtator 2025”.*
2. *Projektvendim: “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”.*
3. *Projektvendim: “Për miratimin shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar në VKB nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar”.*
4. *Projektvendim: “Për një ndryshim në VKB nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar”.*
5. *Projektvendim: “Për miratimin shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar në VKB nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar”.*

6. *Projektvendim: “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të tij në Bashkinë Shkodër”.*
7. *Projektvendim: “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.*
8. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është present në salla, mbledhja deklarohet e hapur.

Z. Luli fillon me leximin e rendit të ditës, gjithashtu shton se shtesë në rendit e kësaj mbledhjeje vjen projektvendimi: “ *Për dhënien në përdorim pa kundërshtpërblim të sipërfaqes prej 2688 m² truall dhe 674 m² ndërtesë objekti bordi i kullimit pasuri me nr. 10/504 dhe nr. 10/80/2.nd,zk 8593 në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit* ”.

Hidhet në votim rendi i ditës , ku rezultojnë **37** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Përpara se të vijohet me projekt vendimet , kërkohet edhe votimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak, datë 25.09.2025, ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e parë të rendit të ditës: *Pr/Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shtator 2025”*. Siç është rënë dakord, kjo pikë nuk ka nevojë për relativitet, prandaj kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **37** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në pikën 2. të rendit të ditës: *Projektvendim: “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”*.

Relaton për këtë pikë **Znj.Kruja**, drejtoreshë, drejtorja e Shërbimeve Sociale, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pyetje e diskutime nuk ka. Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, kryetarët e grupeve shprehin të gjithë pro projektvendimit.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **37** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e tretë të rendit të ditës: *Projektvendim: “Për miratimin shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar në VKB nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit*

2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër ”, i ndryshuar”.

Relaton për këtë pikë **Z.Mema**, drejtori i përgjithshëm i Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Z.Bjanku**, i cili shprehet se në vazhdimin e këtyre projekteve të financuara nga BE-ja dhe nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë ndodh që këto kanë si qëllim që pas mbarimit të financimit të vazhdohen pastaj nga vetë Bashkia. Fatkeqësisht mund të themi, që përgjithësisht gjithçka që lidhet me shtetin shqiptar, kur fiton këto donacione, me mbarimin e donacioneve mbyllet edhe aktiviteti dhe zakonisht nuk vazhdohet qëllimi i projektit që është për ta. Prandaj kërkoj një sqarim: A keni vlerësuar këtë gjë dhe a do të arrijmë që ta vazhdojmë në këtë, këtë nismë që tani po na e mbështesin ndërkombëtarët? Dhe a mundemi ne si bashki që ta vazhdojmë vetë këtë iniciativë?

Përgjigjet **Z.Mema** duke thënë se me drejtë, qëndrueshmëria e projekteve dhe e fondeve që jepen nga Bashkimi Europian është një nga pikat kryesore, edhe përgjatë aplikimeve, edhe si kriter vlerësues. Edhe ky projekt me detajet e tij dhe të gjitha planet dhe aktivitetet do të kalojnë edhe përmes Këshillit Bashkiak. Do të bëhen pjesë integrale e administrimit të menaxhimit të mediave publike për sa kohë që vetë stafi i Bashkisë do ta zbatojë këtë projekt dhe nuk do të jetë një staf i jashtëm që vjen e zëvendëson fondin, kryen projektin dhe ikën, por i gjithë procesi i njëjtë si projekt do të jetë brenda Bashkisë dhe prandaj kemi synuar për ta mbajtur, në mënyrë që të ketë vazhdimësi edhe më pas.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, kryetarët e grupeve shprehen të gjithë pro projektvendimit.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **40** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 4.: *Projektvendim: “Për një ndryshim në VKB nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër ”, i ndryshuar”.*

Relaton edhe për këtë pikë **Z.Mema**, drejtori i përgjithshëm i Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administrata

Fjalën e merr **Z. Shestani**, e cila kërkon të dijë se sa banake janë sot funksionale? Sepse në fillim të vitit, numri ka qenë shumë i vogël dhe rritja e këtij numri ka qenë edhe qëllimi i kësaj SH.a-je.

Përgjigjet **Z.Mema** duke thënë se janë aktualisht janë 83 përdorues.

Vijon **Z.Shestani**, e cila thotë se propozon që kjo taksë duhet të parashikohet dhe duhet të bëhet ndryshimi në paketën fiskale. Jo të subvencionojmë, sepse taksat e qytetarëve janë ato që do të paguajnë edhe këtë tridhjetë mijë lekësh diferencë. Prandaj unë mendoj që për këto dy muaj ne do t'i ndihmojmë tregtarët dhe jemi dakord që ata të subvencionohen. Por të mendojmë se kjo vlerë që ne po akordojmë sot i shkon Skodrinonit, i shkon tregjeve, pra asaj për të cilën ne nuk po shohim

se ka ndonjë veprimtari. Që vitin e parë doli me humbje, të shohim si do dalim prapë këtë vit. Por propozoj që paketa fiskale e vitit dy mijë e njëzet e gjashtë të ketë një tarifë më të ulët për këto dhe jo subvencionim për këto banakë. Pra, të parashikojmë një taksë më të ulët për ato tregtarë.

Z.Mema: Me tarifën e mëparshme ishte në pamundësinë totale të Bashkisë Shkodër, që me të ardhurat përfituara nga tregu të bëjë një rikonstrukcion edhe një investim. Edhe një investim, i bërë krijoi disa kushte dinjitoze për tregtimin ditor pavarësisht se të hapur por janë kushte të mjaftueshme dhe krejt dinjitoze për këto tregtarë. Planifikimi i kësaj tarife shtatë mijë lekë është një reflektim i qartë i një politikbërje nga ana e Bashkisë Shkodër për Sh.a -në. Kjo tarifë nuk reflekton vetëm kostot, shpenzimet për mirëmbajtjen dhe administrimin e këtij tregu, por reflekton edhe mundësinë për të krijuar të ardhura për të ndërtuar vetë tregje. Pra, të kemi një ndërmarrje, e cila ka një vizion, dhe nuk është një shërbim publik, por është një ndërmarrje me një vizion që në bazë të disa të ardhurave arrin që pas disa viteve të krijojë edhe mundësinë për të investuar në tregje të tjera. Ne e dimë që Shkodra ka nevojë për tregje të tjera dhe nuk mund të na ndalojë gjithë kohës buxhetit i Bashkisë. Prandaj propozojmë për një periudhë të përkohshme që të jetë kjo mbështetje karshi tregtarëve të Rusit edhe karshi menaxhimit të qëndrueshëm të Sh.a-së.

Përsëri Znj.Shestani: Atëherë në opinionin tim, kjo paguhet me taksat tona. Buxheti i saj, vjen nga buxheti i Bashkisë, janë taksat tona. Dhe normalisht, ne i marrim tregtarëve, po flasim me të vjetra katër dhjetë mijë lekë sot. Dhe tridhjetë mijë lekëshin e paguajmë prapë me taksat tona. Për më tepër ndërtimi i kësaj sh.a-je e rriti taksën prej dhjetë mijë lekë, në shtatëdhjetë mijë lekë, shtatëfish. Dhe e rriti me qëllimin që këto tregjet, këto banakë, të shfrytëzohen në masën njëqind për qind. Ne menduam se do të mbledhëshim gjithë tregtarët aty. Dhe dalim që sot nuk janë shfrytëzuar, pra politikbërja ka dështuar e para. E dyta, taksat e qytetarëve ku po shkojnë dhe po e rrisim taksën. Pse? Në qoftë se vendosni për këtë rritje, se dihet i keni edhe votat, pse nuk e fusni në paketën fiskale ndryshimin e vlerës sepse prapë do të mbesin barrë për tregtarët aty dhe prapë pas një viti do vijmë dhe do të kërkojmë subvencionim për ata. Prapë, pra, me taksat, në një kohë që sh.a.j-a e merr buxhetin. Kjo është e para dhe e dyta që doja të theksoja është se pse nuk kemi një përfaqësues të kësaj sh.a-je asnjëherë në mbledhje, që të na japin shpjegime në lidhje me aktivitetin e saj dhe në lidhje me nevojën se pse është ky shtatëdhjetë mijë lekësh dhe nuk kemi asnjëherë një relacion çfarë ka bërë kjo sh.a deri tani.

Z.Bjanku shton se në vijim të fjalës së zonjës Shestani, unë në mbledhjen e komisionit për aq sa kishte kurum kam kërkuar që përfaqësuesi i kësaj shoqërie të ishte i pranishëm në mbledhjen e Këshillit, dhe në një farë mënyre gjetëm një lloj dakordësie që në mbledhjen e Këshillit do të ishte dikush nga kjo shoqëri për ta mbrojtur një farë mënyre dhe për të na dhënë një lloj sqarimi se si do të vazhdohet, sepse gjatë mbledhjes u ngritën disa problematika që lidhen edhe me atë tregtinë e pandershme që i krijohet atyre tregtarëve të cilët zhvillojnë aktivitetin e tyre në market dhe problemet e tjera, të cilat ndoshta do duhet të ishin pjesë e një relacioni pak më të zgjeruar.

Fjalën e merr zv/Kryetari i Bashkisë **Z.Beka**, i cili shprehet se do ishte e pamundur të merrte një përfaqësues kësaj here, por mendon se Bekimi e zëvendëson më së miri me eksperiencat që ka. Ai shton se ky është një diskutim i hapur dhe jemi për gjithë opsionet e mundshme që edhe vetë këshilltarët e ju do sugjeroni për me për t'i votuar, por thjeshtë të kuptojmë pak thelbin e kësaj. Për Sh.a-në dhe rastin konkret për tregun e Rusit, duhet të kuptoni që nuk është Sh.a-ja që ka rritur

kostot, ato janë standarde dhe është cilësia e ofrimit të një tregu të ri që rrit koston. Pra, kjo është gjëja e parë. Krahasojmë se si ishte. Diferenca është shumë e madhe dhe është e qartë për të kuptuar që për një standard të tillë të një tregu ka kosto krejtësisht të tjera për të mirë. Për të shërbyer, për të menaxhuar. Dhe kryesorja për të qenë në gjendje po të njëjtë për qëndrueshmëri edhe në vitet tjera. Dhe e gjitha kjo ka të bëjë me atë koston që ne e kemi ndarë me ju dhe e kemi diskutuar edhe edhe herën tjetër. Koncepti i Bashkisë është që të krijojmë sa më shumë shërbime dhe të largohemi nga koncepti i Bashkisë që vetëm pret lekë, sepse ne kemi potencial dhe mundësi shumë të madhe që të gjenerojmë të ardhura dhe ky është koncepti edhe i krijimit, për të gjeneruar të ardhura. Në periodhën në vazhdim jo vetëm me tregun, por edhe me opsione të tjera që do të keni, edhe me shërbime të tjera ekstra për qytetarët duhet të krijojmë mundësi të gjenerojmë të ardhura.

Z.I.Sokoli, thotë se këtu u tha në kuadër edhe të diskutimit për Sh.a-në, që Bashkia ka një vizion fiskal dhe jemi dakort por ne, në fakt e kemi paralajmëruar dështimin e kësaj Sh.a-je me këto tarifat e rritura. Pyetja është shumë konkrete, si mendoni që ky vizioni juaj fiskal do të shpëtojë me këtë rialokimin shtatë milionë lekë të vjetra? Dhe a mund të jemi në një rezultat tjetër të ndryshëm, mbasi të realokojmë këtë shtatë milionë lekëshin?

Përgjigjet **Z. Mema**, duke thënë se përpara fillimit të investimit në tregun e Rusit, ka pasur diku një numër prej 50 deri në 61 tregtarësh që kanë përdorur hapësirat e tregut të Rusit. Aktualisht sot ka tetëdhjetë e tre tregtarë që përdorin këto hapësira, pra ka një rritje edhe në përdorues edhe është një punë e vazhdueshme që bëhet si nga policia bashkiake, si nga struktura të tjera të bashkisë, në mënyrë që tregtarët ambulantë që tregtojnë në rrugë, të futen brenda edhe të jenë të sistemuar, të fiskalizuar edhe brenda të gjitha rregullave. Pikërisht prandaj është vendos edhe propozohet një mbështetje për këtë vit, por edhe për vitin tjetër, sepse ky e dimë të gjithë shumë mirë që nuk është një proces që kryhet brenda një dite. Prandaj vendoset dhe propozohet kjo mbështetje për një periodhë të përkohshme, në mënyrë që të gjithë ato tregtarët që janë në treg të jenë të rregullt, të vijojnë me pagesat, edhe të bien dakord me këtë pagesë, në mënyrë që edhe të tjerët të vijojnë të futen në treg dhe të plotësojnë numrin njëqind e pesëmbëdhjetë që kemi.

Znj. Mehmetaj shprehet se sa për sqarim për ata që po na ndjekin, po flasim për një aktivitet të mirëfilltë ekonomik, që do të thotë që Sh.a-ja është krijuar dhe është votuar nga Këshilli Bashkiak. Në fakt ajo duhet të jetë e aftë që të dalë me fitim ose minimumi të mos dalë me humbje. Megjithatë, ajo çfarë është e rëndësishme është pjesa ku diskutojmë për uljen e tarifës. Tani ndoshta më korrigjojnë përfaqësuesit e Bashkisë, po ajo çka kam lexuar nga relacionet dhe nga kërkimet që kam bërë, ky shtatë mijë lekëshi reflekton qartazi vetëm koston, që do të thotë koston e mirëmbajtjes, qerasë aty brenda, pastrimin, drita, ujë dhe çdo gjë tjetër. Kështu që nëse ne flasin për ndryshim të paketës fiskale, dhe ulje të tarifës do të thotë edhe ulje e standartit. Jam shumë dakord për këto dy muaj, sepse ne kemi qenë në komision dhe në fakt gjatë zhvillimeve të komisionit kemi pasur prezent edhe tre apo katër përfaqësues, ose më saktë tregtarë, shumica prej tyre janë ata individë të cilët mund të kenë 20 edhe 30 vite në atë treg, patjetër që mbështes kërkesën e Bashkisë Shkodër për të subvencionuar për muajin nëntor dhe dhjetor por duhet të kemi kujdes kur shprehemi për ndryshime në paketën fiskale.

Znj.Kavaja thotë se do dëshironte të fokusoheshim pak më shumë te tregtarët, duke marrë parasysh sigurisht përmirësimin e kushteve të dukshme dhe shumë evidente tashmë të tregut. Në dijeninë time nga biseda që kam patur herë pas here me disa prej këtyre tregtarëve, kërkesa e tyre

e vazhdueshme ka qenë që të ulet pak kostoja, pra ato të ndihmohen, dhe ky subvencion besoj që i ndihmon shumë. Edhe, ashtu siç u tha edhe pak më herët, rritja e numrit të tregtarëve në këto banaqe, në këto tregje ka ulur edhe numrin e atyre që janë tregtarë ambulantë dhe që deri dje kanë shitur në rrugë. Dhe tashmë janë afruar tregut duke punuar në mënyrë formale, ashtu siç duhet. Besoj që një konsultë me ta, do të na tregonte më shumë nëse ky është vendimi i duhur, të cilin e përkrahim dhe mbështesim, sepse nuk ia lejojmë dot vetes të ulim standardin. Në të kundërt do të shkojmë tek vitet që kemi qenë më përpara, kur tregu i Rusit, që ka qenë në kushte shumë të këqija, ndaj ndoshta duhet ruajtur kjo shumë, që është caktuar tashmë prej shtatë mijë lekësh, po të jepet ky subvencion për t'i ndihmuar që ata të marrin frymë disi. Dhe të shohim në vazhdim se si do të veprohet dhe se si do të procedohet.

Znj. Shkrela, shprehet se u tha që ky subvencion do të jetë edhe për 2026, jo vetëm për dy muaj, dhe ne patjetër që jemi për ndihmën e këtyre tregtarëve dhe po kërkojmë, ta rishikoni për vitin 2026, të rishikohet paketa fiskale. Pse duhet ne taksapaguesit shkodran të japim lekët për të mbajtur Skodrinomin, që mirë vitin e parë doli me humbje, por edhe vazhdimi nuk duket i mirë. Patjetër që jemi dakord të ndihmojmë këta qytetarë, por jo të abuzohet për me mbajtë gjallë këtë ndërmarrjen, që bën tre vjet. Me taksat e qytetarëve duke paguar rroga e shtesa përditë në një kohë që investimet po tkurren përditë, kur në fakt qyteti ka nevojë për investime. Prandaj mos na flisni, ju lutem, si të keni bërë tregun e Rusit, si tregu i Parisit, sepse po flini si me qenë në Paris, por jemi në Shkodër, ku varfëria është ekstreme dhe qytetarët dojnë me pa ndryshim, por dojnë me pa edhe investim, jo vetëm të paguajnë patronazhistët e PS-së.

Z.I.Sokoli thotë se në fakt, këtu është cituar që ka rezistencë për pagesën e tarifës. Pra, në fjalën e fillimit të relatuesit u tha që ka rezistencë për pagesën e tarifës së tregut. Pyetja ime është edhe njëherë, si do ta shfrytëzojmë ne maksimalisht këtë shtatëqind mijë lekësh, në mënyrë që sjellja e këtyre tregtarëve të ndërrojë dhe mos të ketë më rezistencë, se kjo është gjëja që ne duhet të kuptojmë. Do ta shfrytëzojmë ne këtë shtatëqind mijë lekësh, do ta riallokojmë që të ndërrojnë pra sjellja e qytetarëve, sepse kjo gjë është paralajmëruar që me paketën fiskale nga grupi jonë. Përsëri Z. Mema sqaron se kjo nuk është vendimmarrje e jona, është një vendimmarrje e cila është bërë bashkarisht nga ata. Pra, ne kemi bërë më shumë se dy-tre takime, edhe me nënkryetarin, edhe me kryetarin e Bashkisë së bashku me këta tregtarë të Rusit, me përfaqësues të tregtarëve të Rusit, ku është marrë angazhimi dhe dakordësia nga ana e tyre për vlerën katër mijë lekë.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou dhe Z.Sokoli janë pro projektvendimit, po ashtu edhe Znj.Shestani shpreh dakordësi që këta dy muaj të subvencionohen dhe të rishikohet paketa fiskale.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **39** vota Pro **0** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 5. të rendit të ditës: *Projektvendim: “Për miratimin shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar në VKB nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër ”, i ndryshuar”.*

Relaton përsëri edhe për këtë pikë **Z.Mema**, drejtori i përgjithshëm i Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administrata

Pyetje dhe diskutime nga ana e këshilltarëve në lidhje me projektvendimin në fjalë nuk ka. Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi lidhur me projektvendimin.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **30** vota Pro **0** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 6. të rendit të ditës: *Projektvendim: "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të tij në Bashkinë Shkodër"*.

Fillon relatimin për këtë pikë **Znj.Kruja**, drejtoreshë, drejtorja e Shërbimeve Sociale, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Z.Bjanku**, i cili sjell në vëmendje rregulloret për titujt e nderit dhe atë për emertesat e shesheve, rrugëve etj, meqënëse janë në një linjë, të cilat akoma nuk janë sjell për miratim në Këshill. Ka kaluar shumë kohë prej ngritjes së Komisionit ad Hoc, janë paraqitur dy drahte dhe qytetarët vazhdojnë e presin me kërkesat e tyre. Dhe kjo nuk është aspak normale. Që në mars kemi dërguar variantin përfundimtar të mendimeve tona dhe që nuk merren në konsideratë, duke u nxjerrë nga një pretekst gjithmonë, jo po drejtorja juridike, jo po kështu e tjerë, e tjerë. Pse nuk kalohen për miratim në Këshillin Bashkiak këto dy rregulloret, të cilat lidhen në mënyrë direkte.

Znj.Gjekaj, shprehet se është e disata herë që e përsëris, jemi në kuadrin e rregulloreve. Ne i kemi trajtuar dy projekt rregullore për titujt e nderit dhe për emërtesat e rrugëve dhe të objekteve të tjera. Jemi brenda linjës së rregullorëve, kemi një vit e gjysëm. Na është ngarkuar një detyrë dhe e kemi kryer . Që në mars kemi dërguar variantin përfundimtar të mendimeve tona dhe që nuk po merren në konsideratë, duke u nxjerrë nga një pretekst gjithmonë, jo po drejtorja juridike, jo po kështu e tjerë, e tjerë. Ndoshta duhet të jemi edhe pak më të sinqertë, çfarë po e pengohen një procedurë e tillë, që nuk kalohen për miratim në Këshillin bashkiak këto dy rregullore, të cilat lidhen në mënyrë direkte me veprimtarinë tonë, për më tepër ka dhe një komision të përhershëm, që merret pikërisht me këtë pjesë dhe është praktikisht i pafunksion në momentin që bllokohet kjo situatë. Nuk e di për çfarë arsye.

Z.Luli kërkon që të vijohet me projektvendimin në fjalë dhe pastaj përgjigjen do ta merrni nga ana e administratës në lidhje me dy kërkesat që paraqitni ju.

Z.Bjanku: Z. Kryetar, edhe një herë po sqaroj, kjo është procedurë, është rregullore e Këshillit. Nuk kam asnjë lloj problematike me administratën. Këto janë rregulloret që miratohen nga Këshilli Bashkiak. Projektvendimin e kemi sjellë ne, i krijuar një grup anëtarësh nga Këshilli Bashkiak.

Përsëri **Z.Luli**, meqënëse i referohesh rregullores, duhet të merret mendimi i zyrës juridike.

Z.Bjanku: Dhënien e mendimit, drejtorja juridike ka patur gjithë kohën e nevojshme për ta dhënë, në qoftë se ka nevojë për mendim.

Sqaron Z.Luli, Nuk është detyrë e Këshillit për të sjellë projekt vendime. Është detyrë e administratës.

Z.Bjanku: Projekt vendimin e kemi përcjellë ne.

Z.Luli: Jo, nuk keni përcjellë projekt vendim ju.

Z.Bjanku: Po, kemi përcjellë projekt rregulloret.

Z.Luli: Si projekt rregullore, kërkon mendimin e zyrës juridike. Për më tepër me firmën e kujt do paraqitet?

Z.Bjanku: Mendimi nuk është i detyrueshëm. Procedura është nisur nga Sekretaria e Këshillit Bashkiak. Ju keni ngarkuar një komision për këtë qëllim. Pra, Këshilli ka ngarkuar një komision, komisioni ka kryer detyrën e vet. E ka depozituar pranë Kryetarit të Këshillit Bashkiak dhe duhet ky i fundit ta bëjë pjesë e rendit të ditës.

Përgjigjet **Z.Luli:** Jo, nuk e bën pjesë kryetari i Këshillit por Kryetari i Bashkisë. Citon këtu edhe rregulloren. Për më tepër përse i përket komisionit, sa vetë e kanë firmosur nga ana e anëtarëve të komisionit?

Z.Bjanku: Kemi një kryetare, besoj që për më tepër flet kryetarja.

Znj.Gjekaj: Atëherë po filloj përgjigjen me pyetjen e fundit që mu drejtua, se sa vetë e kanë firmos këtë draft rregullore. Kjo është një draft rregullore, nga një komision ad Hoc i ngritur me një urdhër të Këshillit Bashkiak. Se sa vetë e kanë firmos, unë nuk e di, sepse nuk jam sekretarja e Këshillit dhe nuk e kam patur unë në dorë për të parë në fund se kush ka firmos. Unë di që unë e kam firmos personalisht, kam vu firmën time dhe besoj që edhe Zoti Anamali e Zoti Bjanku mund ta konfirmojnë sepse kemi qenë pikërisht në tre anëtarë të këshillit që e kemi punuar atë projekt rregullore në detaje. Në djeninë time, di që zonja Shllaku ka ardhur për ta firmosur, për të tjerët nuk kam dijeni. Unë mbaj përgjegjësi dhe them me garanci që unë e kam firmos atë projekt rregullore. Ne i kemi prezent edhe zonjën Duhani, zotin Shkjaun dhe zonjën Shllaku në sallë, kështu që mund të konfirmojë nëse e kanë firmosur apo jo. Nëse nuk është firmosur, atëherë më falni se po ju them, po ishte përgjegjësi e juaja, e Sekretarit të Këshillit dhe e Kryetarit, që të na vinit në dijeni që nuk është firmos dhe mund të merrni masa, për ta shkrirë fare këtë komision dhe t'ia delegoni dikujt tjetër. Sepse është e papranueshme që prej më shumë se një viti, që është dorëzuar kjo draft rregullore nuk mund të vijë në Këshill. Ka afate të caktuara ligjore, ka një kod procedure administrative që detyron secilin prej nesh kur ne bëjmë një detyrë publike. Dhe sot ne duhet ta kishim prej kohësh si projektvendim në listë për ta miratuar.

Për sqarim, **Z.Luli** thotë se ju keni depozitu dy draft rregullore. Rregullorja e parë që është propozuar nga ana e komisionit është firmosur vetëm nga tre anëtarë. Ndërsa rregullorja e dytë është propozuar nga Zoti Bjanku dhe Zoti Anamali. Janë dy variante për secilën draft rregullore. Pra brenda komisionit ka patur mendime të ndryshme. Ju lutem firmosni të gjithë anëtarët, që të vijnë me procedurën. Për të qenë transparent me të gjithë, njëri nga variantet është firmosur nga dy anëtarë, kurse tjetri nga tre anëtarë, ku dy prej tyre kanë firmosur me rezerva lidhur me një nen. (Tregon këtu dokumetin) Firmosni dhe sillni e protokolloni pranë sekretarisë dhe merrni mendimin e zyrës juridike.

Z.Shkjau shprehet se e rëndësishme është të gjindet zgjidhja e saj, që të mos mbajmë peng njerëzit që presin tashmë prej vitesh.

Z.Luli i drejtohet **Znj.Leqejza**: Të lutem për temologji, se Zoti Bjanku ndërhyri. A janë dy draft rregullore apo është një draft rregullore me dy variante?

Znj.Leqejza: Një draft rregullore me dy variante.

Z.Bjanku, atëherë jo një variant, jo dy....jo firmat, jo etj....Unë e bëj punën time, po nuk i detyroj unë këshilltarët të firmosin. Unë bashkë me Zotin Anamali, kemi paraqitur një variant dhe e kemi sjellë edhe me rrugë postare.

Përsëri **Z.Luli**: Atëherë, zoti Bjanku, edhe njëherë për tu sqaruar përpara publikut Atëherë, këtu është draft rregullorja e firmosur nga tre anëtarë. Edhe për kamerat, ju lutem, janë tre anëtarë. Atëherë, emrat Florjan Bjanku, Plarent Anamali dhe Marina Duhani. Prandaj mos adresu akuza.

Z.Bjanku : Ka qenë drejtori i mëparshëm që e ka pranuar, që jemi duke u marrë, jemi duke trajtuar dy variantet dhe do t'ju japim mendimin tonë shpejt. Sot na jepet një tjetër version.

Përsëri **Z.Luli**: Atëherë në diskutime jashtë rendit të ditës do sqaroheni nga ana e drejtorisë Juridike, për projektvendimin në fjalë dhe diskutojmë këtë pjesë. Komisioni duhet të firmosë , të bien në dakordësi dhe ta mbyllim këtë çështje.

Vazhdon me relacionin e përgatitur për projektvendimin nr.6, **Znj.Kruja**.

Pyetje e diskutime për projektaktin nuk ka, kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve,ku Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehen pro, kurse Znj.Shestani shprehet se do të abstenojnë der isa të paraqiten edhe projekt rregulloret që u diskutuan.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **26** vota Pro **0** Kundër **12** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e radhës: *Projektvendim: “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”*.

Siç është rënë dakort edhe kjo pikë nuk ka nevojë për relativim. Kryetarët e grupeve shprehin të gjithë dakordësi.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën shtesë të rendit të ditës: : “ *Për dhënien në përdorim pa kundërshtpërblim të sipërfaqes prej 2688 m² truall dhe 674 m² ndërtesë objekti bordi i kullimit pasuri me nr. 10/504 dhe nr. 10/80/2.nd,zk 8593 në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ”.*

Relaton për këtë pikë Zv/kryetari **Z.Preka**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr përsëri **Z.I.Sokoli**, i cili thotë se aty janë dy inspektorate, inspektorati i pyjeve dhe emergjencat civile të Bashkisë. Si do të veprohet me këto dy institucione?

Përgjigjet **Z.Preka** duke thënë se siç e dini, kemi kaluar shumë projektvendime për kërkesa dhe miratime për të marrë prona në favor të Bashkisë Shkodër, këto për t'i vendosur në dispozicion të projekteve, që tashmë po zhvillohen në Bashkinë Shkodër.

Bashkia Shkodër aktualisht ka disa pasuri, të cilat i kanë kaluar në pronësi dhe janë transferuar në pronësi me fushë përdorimi për sistemimin e vendit në shërbim të administratës. Kemi disa objekte, si ish konvikti, Safet Spahia, i cili po rikonstruhohet dhe ka ambiente të bollshme aty, si dhe objektet e tjera të cilat sot Bashkia Shkodër i ka në pronësi, ku do të bëhet sistemimi i emergjencës civile dhe inspektoriatit të pyjeve pranë këtyre ambienteve.

Pyetje e diskutime të tjera për projektaktin nuk ka, kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projekt aktin.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në pikën e fundit të mbledhjes, *diskutime jashtë rendit të ditës.*

Fjalën e merr Znj.**Gjekaj**, e cila shprehet se ka një propozim që kërkon votat e këshilltarëve, Ajo shton; do ju lutesha dy minuta pa u larguar ta dëgjoni si propozim, pastaj e dini vetë nëse e votoni apo jo. Atëherë... ndodhur në kushtet e një situate, e cila është bërë problematike për banorët e Qarkut të Bashkisë Shkodër. Problematikën do ta vazhdoj sa herë do jetë e nevojshme derisa të marrim një zgjidhje dhe një përgjigje nga institucioni i ASHK-së. Për të gjithë ne, përfaqësuesit tuaj është ligji 139 kryesor mbi të cilin ne funksionojmë. Bazuar edhe në nenin 37 të rregullores, e shoh të nevojshme duke marrë dhjetëra ankesa nga banorët e Bashkisë tonë, po dhe më gjerë, në lidhje me sorollatjen që i bëhet qytetarëve përsa i përket procesit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, nuk zbatohet ligji, VKM-ja që ka dalë për zbatim të saj. E për pasojë, sot trashëgimtarët ligjorë apo edhe përdoruesit faktikë e kanë të pamundur që të zhvillojnë pronën e tyre, që e kanë trashëgimi apo janë përdorues faktik sipas ligjit. Them dhe njëherë, ndodhur në këto kushte kur ne harrojmë që në fakt në një vend demokratik ligji është bërë për ta orientuar dhe për t'i dhënë zgjidhje dhe shërbim qytetarëve dhe jo siç kemi filluar ta përdorim ne, ligjin e përdorim si një formë për t'i ndëshkuar qytetarët apo për t'i nxjerrë pengesa. Unë kam një draft propozim mbi bazën ligjore që e citova. Kërkoj që të thirret një përfaqësues i ASHK-së Shkodër në interpelancë, të jetë brenda muajit dhe në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Bashkiak të jetë prezent një përfaqësues i ASHK-së. Ku secili nga ne si anëtarë të drejtojnë ankesat dhe pyetjet që i kanë nga qytetarët. I bëjmë pyetjet, ia parashatrojmë në lidhje me moszbatimin e ligjit. Mua më duket shumë e nevojshme dhe prandaj kjo kërkesë do doja dhe ftoj të gjithë anëtarët e këshillit, që këtë nismë ligjore timen po e quaj nismë si anëtare e këshillit që ma lejon rregullorja dhe Ligji 139/2015, të bëjë propozimin, ta miratojmë bashkë dhe të sjellim si një kërkesë si Këshill Bashkiak për të thirrur në mbledhjen e ardhshme një përfaqësues nga ASHK-ja. Zoti kryetar, unë do të doja shumë që kjo kërkesë të hidhej në votim, të votohet në mënyrë që kërkesa mos të shkojë në emrin e një individi, por të jetë një kërkesë e unifikime apo me shumicën e dakordësisë të anëtarëve që jemi sot present.

Përgjigjet **Z.Luli**, duke thënë se nuk mund të hedhim në votim një kërkesë të tillë, se nuk ka procedure për këtë. Paraqitni kërkesën, do të shqyrtohet dhe do kërkohet mendimi i zyrës juridike dhe mendimi i zyrës financiare, kur ka efekt financiar dhe ju do keni një përgjigje ligjore për këtë.

Përsëri **Znj.Gjekaj** kërkon që kërkesa e saj të hidhet në votim pasi nuk ka asnjë ligj dhe asnjë procedurë që e pengon këtë. Nuk është aspak mirë që një kërkesë, e cila do i vinte në shërbim qytetarëve të Shkodrës, që e kanë këtë problematikë ta shtyni në një formë të tillë. Ishte një nisëm në dobi të qytetarëve për të thirrë një përfaqësues të ASHK-së në interpelancë. Po e saktësoj edhe një herë, nuk ka asnjë pengesë ligjore,

Fjalën e merr **Znj.Duhani**, e cila shpreh një kërkesë nga banorët dhe prindërit të shkollës “Ndre Mjeda”. Duke qenë se rruga nga Parruca në Xhabie është me një sens qarkullimi. Rruga paralele nga shkolla në Parrucë është dykalimëshe, e cila është një rrugë krejt e ngushtë mes pallatesh dhe banorët kanë një kërkesë; që rruga në fjalë të bëhet me sensin e kundërt një kalim. Thjesht sepse aty krijohet një kaos dhe prindërit dhe banorët aty bllokohen, bëhen vonë, edhe nuk ia dalin dot.

Z.Pashuku shpreh një shqetësim të banorëve të Bërdicës lidhur me një çezme të vendosur tek një trumë shumëvjeçare, nga vetë ata, por ka dy muaj që ai burim është ndërprerë nga ujësjellësi. Flitet për zonat e Nën Shkodrës, ku aty ka marrë ujin nga Ujësjellësi që furnizon Bahçallekun. Po ashtu në fshatin Trush, janë rreth katër mijë banorë, ku aktualisht nuk ka ujësjellës. Edhe banorët e zonës së Bërdicës dhe Dajçit kanë problem me ujësjellsin. Duhet të ndërmjetësoni me drejtorinë e Ujësjellësit për zgjidhjen e situatës.

Znj. Kopshti, ngre një shqetësim lidhur me rrugën nga Ura e Bunës për në fshatin Muriçan, për rreshjet e rëna ditët e fundit duke vështirësuar kalimin në këtë rrugë. Për më tepër që dihet që kjo rrugë është pikë lidhëse dhe i shërben edhe turizmit. Ajo kërkon të dijë se kur do marr zgjidhje kjo problematikë.

Z. Anamani shpreh një shqetësim lidhur me shtëpitë e vjetra shkodrane, që janë vlera e trashëgimisë kulturore të qytetit tonë. Ne si bashki, me ligjin 139/2015, duhet të ushtrojmë funksionet për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre vlerave të trashëgimisë kulturore, duke parë këtë problematikë që kanë. Problematikën që kemi në lidhje me mirëmbajtjen e këtyre shtëpive, të cilat kanë mbetur shumë pak në qytetin tonë. Ne reduktojmë fonde për të subvencionuar Sh.a, por asnjëherë nuk planifikojmë fonde për me mirëmbajtjen e këtyre shtëpive, të cilat janë në zhdukje. Shoh të udhës që me buxhetin e ardhshëm të planifikojmë disa fonde edhe për mirëmbajtjen e këtyre shtëpive, sepse duhet të jemi në mbrojtje të vlerës trashëgimisë kulturore.

Znj. Shllaku shprehet se me datë 16 tetor 2005, i kam dërguar një kërkesë zyrtare Bashkisë Shkodër, ku i kam kërkuar një informacion të plotë mbi buxhetin dhe shpenzimet e Këshillit Bashkiak për periudhën janar-tetor 2025. Përgjigja e ardhur është patjetër jo e plotë nga administrata e Bashkisë Shkodër, ku më janë vënë përpara vetëm disa zëra buxhetorë, ku ne tashmë edhe e dimë sepse i kemi votuar vetë këto në Këshill. Por ajo çfarë unë kam kërkuar është detaje mbi shpenzimet reale, aktivitetet e zhvilluara nga procedurat dhe miratimin e tyre. Pra, duke u bazuar edhe në ligjin 139/2015 në cilësinë e këshilltarës bashkiake, po ashtu edhe për sa i përket qytetarëve të Shkodrës, që kanë të drejtë të informohen për këtë, për këto fonde, pra se ku shkojnë dhe se si janë shpenzuar. Së dyti, ngre një shqetësim që besoj është nga të gjithë dhe i kemi vënë re, janë korsitë e biçikletave. E shohim çdo ditë që korsitë e biçikletave tashmë janë të zëna nga shitës ambulant, si dhe kalojnë motoçikleta. Kjo është kthyer në shqetësim për sa i përket qytetarëve që përdorin biçikletë. Do të kisha kërkuar nga Policia bashkiake, patjetër, duke u mbështetur tek ajo që i përket këtyre, pra monitorimin e këtyre korsive të biçikletave, si dhe

vendosjen e sinjalistikës përkatëse. Që mos ketë më situatë të tilla. Po ashtu tjetër gjë është edhe pjesa e atij përbindëshi që po bëhet në hyrje të qytetit, po që po bëhet në qendër të qytetit të Shkodrës. Po, kjo është me të vërtetë përbindësh dhe më vjen shumë keq që asnjëri nga kolegët këtu, përveçse kolegut që kam në krah, që është Imeldi e ka ngritë si shqetësim. Por duhet ta dimë të gjithë që është një shqetësim shumë i madh për të gjithë banorët e Shkodrës. Aty është qendra e qytetit të Shkodrës dhe identiteti historik, ndaj çdo ndërhyrje aty kërkon kujdes, transparencë dhe konsultim me publikun. Zhvillimi nuk mund të bëhet pa respektuar karakterin urban dhe historik të qytetit tonë, sepse në atë mënyrë rrezikojmë të humbasim atë që na bën të veçantë, historinë dhe kulturën e qytetit të Shkodrës, prandaj kërkoj që Bashkia të informojë publikisht Këshillin dhe qytetarët për projektin, lejet dhe kriteret që janë ndjekur. Shkodra nuk është kundër zhvillimit, por është kundër mungesës së transparencës të ndërtimeve që çenojnë shpirtin e qytetit.

Përgjigjet **Z.Rustemi**, drejtor i Policisë Bashkiake duke thënë se përsa i përket monitorimit të korsisë së biçikletave, në lidhje me shitësat ambulantë e thënë me përgjegjësi të plotë, që nuk ka as edhe një shitës ambulant që ushtron aktivitetin e tij në korsitë e biçikletave. Ka pas vetëm një rast të izoluar që është marrë menjëherë masa ndaj tij. Po ashtu është shmang si problematik pjesa përsa i përket kalimit të motorrave ose mjeteve tjera motorrike në korsinë e biçikletave. Jam plotësisht dakord që është problem shqetësues, por me një vendim të Këshillit bashkiak janë heq kompetencat Policisë bashkiake që të monitorojë. Kemi bërë kërkesë që të na rikthehet edhe herë si kompetencë dhe shpresojmë vitin e ardhshëm. Me paketën e re fiskale na jepet edhe mundësia që ne të marrim masa, qoftë për korsitë e biçikletave, qoftë edhe për sa i përket menaxhimit të mjeteve ose të kundërvajtjeve në pedonalet e qytetit. Siç e keni parë gjatë verës, kemi qenë të detyruar që të marrim masa ekstreme duke bllokuar komplet hyrjet në bedonale sepse nuk kishim asnjë mënyrë, asnjë kompetencë për ndëshkimin e mjeteve që futen ose që abuzojnë në këto zona. Me paketën e re fiskale, shpresojmë që të na rikthehet edhe njëherë ajo kompetencë.

Znj. Shkrela gjithashtu shpreh një shqetësim të banorëve të rajonit numër pesë. Por më parë dëshiron të ndalet si kolegja Shllaku tek kulla që po ndërtohet sepse shton ajo, ne kemi një Kryetar Bashkie që në fakt nuk vjen në mbledhje të Këshillit. Hera e fundit që ka qenë, ka qenë në mbledhjen e buxhetit për të prezantuar ato investime që do t'u bënin në 2025, por që nuk janë bërë dhe nuk po i shohim, investimet strategjike dhe vizionin qeverisës. Sepse unë e kam thënë dhe e them, ai këtu erdhi për të hapur fushatën si drejtues politik, jo si Kryetar bashkie, me prezantimin e atyre projekteve që prezantoi. Por në asnjë moment nuk na prezantoi këtu kullën, që lindi si këpurdha pas shiut, prandaj ky Kryetar i bashkisë të tregohet pak më transparent sepse ky ka qenë premtimi i tij. Prandaj të lënë partinë sepse mbledhjet atje i zhvillon rregullisht dhe të tregojë qytetarinë, të tregojë përgjegjësinë edhe si Kryetar bashkie duke qenë këtu në mbledhjet e Këshillit bashkiak. Gjithmonë të ketë transparencë me qytetarët, por edhe me ne, anëtarët e Këshillit Bashkiak. I takon atij të jap informacion lidhur me kullën në mbledhje të Këshillit. Disa prej nesh këtu kemi realizuar edhe një protestë një vit më parë, prandaj kemi të drejtën tone që të marrim përgjigje, kemi të drejtën tonë si përfaqësues të qytetarëve shkodrane. Duhet të na bëhet transparent projekti, si u mor vendimi, është bërë konsultimi publik për këtë apo jo. Në Shkodër ka rolin e Kryetarit të bashkisë, nuk ka rolin e drejtuesit politik.

Ajo vijon me shqetësimin i banorëve, por edhe të tregtarëve që është problemi i furgonëve, të cilët parkohen përpara bizneseve, por edhe në hyrjet e pallateve. Shumë herë kanë drejtuar ankesa në fakt tek Policia bashkiake, por edhe në komunikimin që unë kam pasur me drejtuesat e furgonëve, shumë prej tyre janë që kanë transportojnë fëmijë dhe kanë problem vendqëndrimin. A mund të ketë

një formë që të vendoset një orar, vetëm për shkollat, lëvizjen e shkollave, sepse nuk mund të parkojnë, nuk mund të lënë fëmijët. Flas për zonën e “Urës së thive”. Ata duhet t'i shoqërojnë me furgon, pra të lihet një orar për shëmbull 7:30-8 dhe një orar në drekë që bëhet dalja nga shkolla, në mënyrë që të mos pengohet edhe çështja e fëmijëve që vijnë nga fshatrat përreth. Pastaj është edhe çështja e parkimeve dyshe aty. Pra duhet të gjendet një zgjidhje në mënyrë që të mos pengohet as tregtarët dhe as furgonët me fëmijët e shkollave.

Përgjigjet përsëri **Z. Rustemi**; përsa i përket parkimeve dyshe kemi marr masa të vazhdueshme në lidhje me këto mjete dhe shkeljet që ato bëjnë në atë zonë. Për shkak të këtyre shkeljeve kemi patur një ankesë nga ana e tyre për ta ulur pak shkallën e ndëshkimit. Madje kam pritur një përfaqësi të tyre në ambientet e Policisë bashkiake dhe kemi diskutuar në lidhje me problematikat dhe shqetësimet që ato kanë. Kurse në lidhje me furgonët që transportojnë fëmijët e shkollave, unë ia kam bërë të qartë që një pjesë e tyre janë ndëshkuar, sepse ata s'kishin asnjë dokumentacion për të transportuar në mjetet e tyre fëmijët e shkollave sepse është shkelje e rëndë sepse i përket sigurisë së atyre fëmijëve. Në momentin që ata do të plotësojnë dokumentacionin, nga ana jonë nuk do të kenë asnjë pengesë që ata fëmijë t'i çojnë deri te shkolla brenda atij orari, para fillimit të shkollës dhe në momentin që do të shkojnë t'i marrin ata fëmijë, por duke respektuar rregullat e qarkullimit rrugor. Pra, u janë bërë të qartë të gjitha detajet që duhen për të mos pasur pengesa nga ana jonë. Në qoftë se ata nuk do t'i plotësojnë këto kërkesa, nga ana jonë do të merren masa ndëshkimore përkatëse, sipas kodit rrugor.

Z. I. Sokoli Faleminderit për fjalën, zoti kryetar, drejtues i seancës. Pyetja ime ka të bëjë me sport, me mos zhvillimin e dy dëgjesave publike që ju. Keni nxjerrë dhe kenë postuar edhe në faqen e bashkisë, pra janë postuar përsa i përket vendimit. për ose konsultimi për planin e lëvizshmërisë, si dhe projektin për trotuarin e rrugës së Shirokës. Më thonë, unë tentova të jem pjesë e këtyre dëgjesave. Në fakt, ato dëgjesa janë për publikun dhe në të dyja rastet, këto dëgjesa nuk janë zhvilluar nga ana e institucionit si të bashkisë, si dhe Të këshillit bashkiak, unë e kam thënë edhe herë të tjera që. Ne këtu në fakt tentojmë të jemi të vërtetë, por gjë e bëni komplet formale, pra angazhimin tuaj e bëni krejt formal dhe ky është rasti. Që ne shohim që angazhimi këtu është komplet formal, nuk ua ndodh ndonjëherë që dëgjesa. Me u njoftu për dëgjesë dhe mos me u zhvillu dëgjesa, dhe kjo më vjen shumë keq që ndodh. Është përgjegjësi e tanëve neve, sepse jemi pjesë e këtij këshilli. Dhe më thanë, du një përgjigje nga ju, se çfarë mund t'i thoni pra kësaj gjëje që ka ndodhur, që ne njoftojmë për dëgjesë. Dhe kemi një mungesë serioziteti të jashtëzakonshme, si nga bashkia, si nga këshilli bashkiak, për mosrealizimin e këtyre dy dëgjeseve.

Z. I. Sokoli merr fjalën pyet së pari lidhur me dy dëgjesat publike të njoftuara nga ana e Bashkisë për planin e lëvizshmërisë dhe për projekti e trotuarit të rrugës së Shirokës. Ai thotë se tentoi të ishte pjesë e tyre , por asnjëra nga ato nuk u zhvillua nga ana e intitucionit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak. Ne në fakt dëshirojmë të jemi sa më real por ju edhe njëherë po bëni gjërat krejt formalisht. Nuk ka ndodhur ndonjëherë që njoftohet dëgjesa dhe nuk zhvillohet. Kjo është mungesë e jashtëzakonshme serioziteti. Po ashtu ai shprehet lidhur me kullën duke thënë që ndërtimi i saj është gjëja më e keqe e mundshme. Në fakt kur mendoj dhe lexoj informacione që më vijnë, që ka dhe iniciativa të tilla të tjera nga ana e Bashkisë, për studimin pjesor të planit të detajuar vendor për zonën historike të qytetit të Shkodrës, mendoj që ka dhe më keq se sa ndërtimi i kullës. Nga informacione që unë kam, ka nisur një procedurë për sa i përket hartimit të planit detajuar vendor për zonën historike të qytetit të Shkodrës. Dhe ky proces, në qoftë se ka filluar

është në mënyrë komplet jo transparente. Nëse ju dëshironi të zhvilloni një proces të shëndoshë dhe keni vizionin e mirë për të filluar një proces të tillë për zonën historike të qytetit, ky proces duhet të jetë minimalisht transparent. Duhet të ketë patjetër përfshirjen e të gjithë aktorëve, sepse është zemra historike e qytetit. Ajo nuk quhet EDV, po quhet plani i detajuar në zonë të rëndësishë kombëtare, sepse nuk është subjekt që mund të trajtohet nga Bashkia Shkodër, por duhet të trajtohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit apo Ministria që është kompetente për këtë zonë.

Përgjigjet Z.Luli lidhur me dëgjesat publike, duke thënë se duhet të jesh i qartë dhe krenar që Këshilli Bashkiak Shkodër është model në gjithë Republikën e Shqipërisë, përse i përket organizimit të dëgjesave publike. Dhe është e vetmja dëgjesë publike, e cila për arsye objektive është shtyrë me datën 7 shtator. Ju gjeni si pretekst për ta diskutuar një gjë të tillë për të fajësuar dhe asnjëherë për të marrë përgjegjësinë si këshilltar, për të marrë pjesë në dëgjesat publike që ne kemi zhvilluar gjatë muajit shtator, për një dokument shumë të rëndësishëm, që është buxheti i vitit 2026 dhe programi buxhetor afatmesëm 2026-2028. Dëgjesa publike që ju folët për shkak të arsyes objektive është shtyrë dhe do zhvillohet me datën 7. Njoftimi është bërë siç bëhet gjithmonë tek faqja e Facebook-ut e Bashkisë dhe faqes eeb të Bashkisë. Dhe dua të sqaroj diçka, që për shkak të volumit, për shkak të punës të jashtëzakonshme që është bërë me hartimin e atij dokumenti shumë të rëndësishëm, përveç grupit të punës, kanë asistuar edhe ekspertë të huaj dhe vendas. Mungesa e ekspertëve të huaj, të cilët kanë drejtuar këtë hartim të dokumentit të rëndësishëm të lëvizshmërisë, bëri që dëgjesa të shtyej. Ne vendosëm që ta shtyjme për të qënë korrekt me ta dhe njoftimi ka qënë krejt korrekt dhe nuk besoj se ka cënuar ndonjë gjë në lidhje me atë që diskutoni. Kurse në lidhje me atë që thatë për objektet që ndërtohen në Shkodër, jo më larg se njëqind metra larg shtëpisë tënde, në cilësinë e anëtarit të këshillit, është ndërtuar një objekt që ka shëmtuar zonën. Nuk ju kam dëgjuar që të thoni një fjalë për këtë nga ana urbanistike, si ekspert i fushës.

Përsëri **Z. I.Sokoli** shprehet se përse i përket procesit të dëgjesave për buxhetin, e kam thënë disa herë që ju shkoni atje, bëni dëgjesa komplet formale. Ju keni përgjegjësinë ligjore bashkë me Bashkinë, që t'i thoni qytetarëve në dëgjesat publike në rajone dhe në njësitë administrative, se cilat janë projektet që do të përfshihen në mënyrë direkte me fish projekte në buxhetin vjetor të Bashkisë. Dhe këtë gjë ju nuk e bëni asnjëherë, po rrini atje dhe dëgjoni thjesht hallet e njerëzve. Dhe kjo është formaliteti ku ju jeni, dhe unë prandaj nuk mund kam qënë pjesë e këtij procesi që ju e trajtoni me komplet formalizëm dhe unë nuk mund të jem pjesë e këtij procesi. Për më tepër dëgjesat janë për publikun, sepse ne i trajtojmë vendimet në komisionet tona. Pra nuk është detyrim që unë të jem pjesë e çdo dëgjese publike, sepse ai vendim vjen në Këshillin bashkiak, si pjesë e komisioneve tona, dhe ajo është instrumenti që unë ushtroj detyrën e përfaqësuesit të qytetarëve.

Z. Shkja, shprehet në lidhje me rrugën nga Isa Buletini deri Tepe, e cila është kthyer në Kandahar, prandaj duhet ndërhyrë. Përse i përket kësaj kullës, kam dëgjuar për këtë kullën shumë të diskutuar. Por ju lutem gjeni një mënyrë tjetër për të sulmuar, keni mënyra sa të duash për të sulmuar, Një gjë që nuk të bën efekt në popull, ti e diskuton kot.

Z. Preka, merr fjalën për t'iu përgjigjur Z.Sokoli. Ai thotë se përse i përket kullës ajo është në bazë të rregullave dhe gjithë konformitetit. Edhe kjo leje që ju e sulmoni, është vendimi i KKTU-së. Ajo është kompetencë e KKTU-së dhe me vendimarrjen e KKTU-së ka leje dhe e ka në pronë të vet të regjistruar. Gjithë hamendësimet, gjithë problematikën tjetër që ju doni ta tjetërsoni dhe të

disinformoni sikur Bashkia Shkodër ka për detyrë t'iu japë llogari. Ju keni organin që ka lëshuar lejën, ku mund t'i bëni të gjitha kërkesat e duhura dhe por jo ta përdorni sa herë vini mbledhje. Po të ishte një lejë e dhënë nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, patjetër që do të kishe argumentimin dhe gjithë informacionin e duhur por nuk është projekti i Bashkisë. Gjitha projektet e Bashkisë që janë prezantuar, po zhvillohen dhe për fat të mirë po i shohin të gjithë qytetarët.

Znj.Shkrela Përgjigje të lutem, nxirrje me diskutimin që i pat me ta në lidhje me të atë rregulloret. Është kulla, kulla pra, sepse është një shitësim dhe ju e dini, dhe ju e dini, dhe një lloj, dhe ju i shihni, është shumë sensitive. Është jashtëzakonisht sensitive. Jemi pranë zhvillimit të Shkodrës, e keni thënë gjithmonë, i keni këto. Të gjitha njerëzit, të gjitha njerëzit, të gjitha njerëzit, të gjitha njerëzit, të gjitha njerëzit, të gjitha njerëzit, të gjitha njerëzit, të gjitha njerëzit, të gjitha njerëzit, të gjitha njerëzit, të gjitha njerëzit, të gjitha njerëzit. Për të gjithë projektonimet që kanë dalë pranë zhvillimit të Shkodrës, i kemi votuar dhe jemi plotësisht dakord. Por për këtë gjë që është shumë sensitive, ju lutem të tregojmë respekt, sepse ajo çfarë ne po kërkojmë dhe po transmetojmë janë. Shqetësimet e qytetarëve të Shkodrës, pra sepse ne jemi votuar nga këta qytetarë dhe minimumi kërkohet transparencë dhe llogaridhënie, qoftë nga bashkia apo në këtë rast.

Znj. Mjeda, drejtoreshë jurike pranë Bashkisë Shkodër, përgjigjet në lidhje me dy draft rregulloret e përgatitura nga komisioni ad Hoc. Ajo thotë se do bëj një përmbledhje që nga fillimi dhe deri në pretendimin e dhënë nga anëtarë të komisionit. Me VKB nr.43 datë 24.10.2023 është ngritur komisioni i përkohshëm për hartimin e projekt rregullorëve për emërtimet e sheshe, rrugëve dhe për dhënien e titujve vendorë të nderit. Ky komision përbëhet nga shtatë anëtarë. Komisioni do ta ushtronte sipas VKB funksionin e saj deri me datë 30.11.2023. Përsa pretendohet, dihet që duhet të zbatohet rregullorja e Këshillit bashkiak, dhe rregullorja e Bashkisë për trajtimin e akteve ose projekt akteve, siç duhet. Jemi para faktit që kemi dy drafte për një rregullore dhe kjo nuk është normale, sepse një komision ad Hoc, ose siç quhet komisioni i përkohshëm, kur ngrihet, ka një qëllim të caktuar dhe ka një procedurë të caktuar për respektimin e punës së tyre që i është ngarkuar, e para është dhënë....

Ndërhyn **Z.Bjanku**, duke thënë se po çenohet një parim shumë i rëndësishëm i Këshilltarit. Nuk mundet, administrata e Bashkisë të çenoj figurën e Këshilltarit dhe Kryetari i Këshillit duhet t'i dalë zot figurës së këshilltarit sepse nuk mundet në asnjë rast administrata e Bashkisë të kontrollojë Këshilltarin...është e kundërta. Duhet që Këshilli i bashkisë të kontrollojë administratën.

Z.Luli i drejtohet Bjanku duke i thënë se nuk i është dhënë fjala prandaj, nuk mund të ndërhyjë në çdo rast, dhe krejtësisht pa vend, në çdo lloj diskutimi, duke prishur procedurën reale të mbledhjes. Administrata e bashkisë po jep mendimin e vet në lidhje me një rregullorje me dy variante.

Znj.Shestani kërkon fjalën duke thënë se nga vetë drejtoria juridike është pranuar që ka mbetur aty vazhdimësia e çështjes, por **Z.Luli** përgjigjet që fjalën e kishte Znj.Mjeda për sqarime.

Vijon **Znj.Mjeda**, duke thënë se pranë Bashkisë Shkodër janë përcjellë dy variante për një rregullore, e cila bie në kundërshtim me vendimin e Këshillit Bashkiak, që i ka dhënë tagër këtij komisioni, që të hartojë një projekt. Dhe nuk është në tagër të Bashkisë Shkodër që të përzgjedhin se cili është drafti i duhur për miratim në Këshillin Bashkiak. Prej atij moment dhe deri sot nuk ka

një variant që të diskutohet dhe të shihet nga Bashkia Shkodër për përcjellje për miratim në Këshillin e Bashkimit.

Znj. Gjekaj: Atëherë në vijim edhe një herë si kryetare e këtij komisioni ad Hoc. Unë në fakt, si rrallë herë, e mbështes qëndrimin e Zotit Bjanku sepse nuk mundet që Znj. Mjeda me gjithë respektin të thotë se kur e ka sjellë komisioni jonë, se kur janë bërë gati draft rregulloret, një punë e cila ka qenë në fakt një punë kolosale për hir të së vërtetës. Për t'i hartuar të dy ato draftë rregullorë, nuk kenë aspak e lehtë për shkak të kohës dhe seriozitetit që kërkon. E kemi marrë përsipër, mendojmë që kemi bërë një punë të mirë dhe e kena depozitu në korrik 2024. Nuk ka nevojë të thuhet diçka që ne e kemi deklaruar vetë dhe është është shumë mirë e verifikueshme. Tani shqetësimi është ky, nga korriku 2024, pse ka ngec puna për këto draft rregullorë, të cilat ne i presim me ardh në Këshill, jo për ne, por për të mirën e kërkesave të qytetarëve, se përveç kërkesave të reja, komisioni këshillimor që do të krijohet, që me ligj duhet të krijohet në fillim të çdo viti, pra në janar të çdo viti, sepse aq e ka vlefshmërinë dymbëdhjetë muaj dhe i bie që ne jemi në limitet e kohës, të shqyrtojë edhe kërkesat tjera. Në janar duhet që ky komision këshillimor të hyjë në fuqi dhe ky është qëllimi. Në qoftë se do merremi me lojra fjalësh do kalojnë katër pesë vite dhe më mirë Z.Kryetar shkrijeni komplet këtë komision ad Hoc. Krijoni një komision tjetër ad Hoc që të krijoj një draft rregullorë, si ta doni ju. Ose le ta heqim fare si kompetencë këtë gjë nga Këshilli, sepse për aq kohë sa i lamë qytetarët me vite pa i dhënë përgjigje në lidhje me emërtimin e rrugëve apo për titujt e nderit i bie që kjo kompetencë që kemi ne s'ka më asnjë vlerë.

Znj. Memetaj, shprehet lidhur me çfarë tha kolegja. Përsa i përket limiteve në kohë, që ndoshta jemi në limite bashkohem me kolegën, por ka një problem. Ajo është një draft rregullorë që është sjellë në dy variante. Ne mund të sjellim plot pesëdhjetë e dy variante. Asnjë anëtar i Këshillit Bashkiak nuk ndalohet dhe kam të drejtë edhe unë nesër të sjell një variant, ashtu siç ta mendoj unë. Detyra e Komisionit është që të sjell një variant ose një draft përfundimtar dhe pastaj mund të kalojë në Këshillin Bashkiak, Prandaj detyra e komisionit dhe më pas e gjitha komisioneve është që të sjellim një variant dhe t'i propozojmë Bashkisë Shkodër për të na e përcjellë në Këshillin Bashkiak për votim. Vetë komisioni ka për detyrë për të punuar për këtë variant, mund të marrin edhe ekspertizë të jashtme, mund t'i drejtohen drejtorisë juridike në Bashkinë Shkodër, plus që shumica prej tyre janë jurista me profesion. Por është njësoj si të flasim për dy variante, si për pesëdhjetë e dy. Prandaj kur të jepni një variant, na e propozoni edhe ne komisioneve të tjera që të vlerësojmë, po ashtu edhe Bashkia Shkodër ta na e sjellë në Këshill për t'u votuar dhe të mos kalohen limitet që përmendi kolega Gjekaj. Prandaj ju lutem, mos të zgjatemi më me këtë temë, sepse kishte edhe problematika tjera të qytetarëve.

Z.Bjanku sqaron edhe njëherë që kjo është një teknikë, teknika e hartimit të aktit administrativ. Është një fushë juridike që besoj që çdo jurist dmth që ka bërë një shkollë të rregullt e di që një komision, një organ kolegjal mund të ndërtojnë disa, pra nuk e detyrojnë në asnjë rast kur bëhet fjalë për anëtarësi, nuk detyrojnë unanimitetin. E rëndësishme është vullneti i mirë për t'i miratuar këto rregullorë, dhe ky vullnet i mirë në asnjë moment, që të jemi të singertë edhe ta shohim njëri-tjetrin në sy nuk ka ekzistuar dhe nuk e di arsyen.

Z.Shkjau thotë se ai gabim që është bërë aty duhet ta rregullojnë këshilltarët, sepse ti e di si funksionojnë këto gjëra. Një rast, prish aty një terezi, një rast tjetër dikujt tjetër. Prandaj mos e diskutoni më.

Znj. Shestani shpreh një kërkesë nga një grup pensionistave për stolat tek shatërvani. Mbase ato dalin për të pushuar dhe aty nuk ka stola. Kjo është një kërkesë nga ato. E dyta, që unë doja të thoja është se kam dy pyetje në lidhje me Velipojën. Kur do të na vihet në dispozicion se sa janë të ardhurat e Velipojës, të plazheve publike të administruara dhe çfarë do bëhet me ato. Mbledhjen tjetër pres një përgjigje. Ajo gjithashtu kërkon të dijë më shumë lidhur me një rrugë paralele me pedonalen në Velipojës, një fond të konsiderueshëm që është miratuar në fillim të vitit .Çfarë po bëhet për të, po mbaron viti, a duhet përsëri vitin tjetër të fillojmë nga fillimi?

Z.Preka: Përsa i përket të ardhurave, do t'iua vëmë në dispozicion në mbledhjen e ardhshme. Kurse përsa i përket projektit të rrugës është në fazë të projektimit nga kompania fituese. Dhe në momentin që do dorëzohet, do të vijojnë procedurat për implementimin e projektit.

Z.Sokoli, përsa i përket kullës, po citoj procedurën e marrjes vendimit të një leje të Këshillit Kombëtar të Territorit. Në qoftë se Bashkia Shkodër e refuzon lejen nuk ka forcë ligjore që ta miratojë lejen nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe kemi disa raste të tilla në Bashkinë Shkodër në vitin 2019. E kam citu këtu, do e citoj përsëri. Ka dhe raste tjera në Bashkinë Lushnjë në vitin 2021, ku një leje e Këshillit Kombëtar të Territorit vjen për mendim në institucionet e linjës në Bashki dhe refuzohet, ndërkohë leja nuk mund të jepet. Pra, ju po fshiheni pas gishtit. Ju i keni dhënë okej miratimit për këtë leje dhe normalisht që Këshilli Kombëtar i Territorit ka marrë vendimin për të zbatuar lejen. Instrumenti që ju duhet të zbatoni është plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Shkodër . Në qoftë se ju nuk e zbatoni, të paktën ndryshoni planin. Është shumë e thjeshtë, sepse plani i përgjithshëm vendor vjen si rezultat i një negociimi publik, i një procesi publik me banorët, me aktorët e tjerë. Ajo është parametri i zhvillimit që i ka dhënë plani, është shtatë plus dy, maksimumi nëntë kate. Kurse ju keni bërë tridhjetë e pesë kate në mënyrë arbitrare. Nuk keni zbatu atë që quhet kushtetuta urbane.

Z.Preka shprehet se çdo procedurë është ligjore dhe është ndjekur ajo procedurë që ndiqet për çdo rast dhe kompetenca e KKTU-së është ajo që i ka dhënë lejen e ndërtimit të subjektit. Nuk është në pronë publike që të kemi ne interes dhe të kemi dhënë ne leje zhvillimore ose të kemi ndonjë synim nga ato që pretendoni ju. Dhe mund të keni patjetër çdo korrespondencë. Patjetër që dhe dosjen mund ta kërkonin në organin që ka lëshu lejen. Thjesht, nëse reagoj po e bëj sepse doni të dizinformoni, dhe dizinformimi nuk është gjë e mirë. Dhe është e mira që të thuhet të vërtetat përsa i përket PDV-së. Është në proces një PDV, dhe do ketë një PDV në konform ligjit dhe I gjithë informacioni do ju vihet në dispozicion.

Z.I.Sokoli, definitivisht ju doni t'ia ndërroni faqen qytetit. Është Institutit Kombëtar i Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore, që duhet të merret me këtë. Nuk e merrni ju nismën për zhvillimin e asaj zone. Lexoni ligjin e planifikimit të territorit, lexoni instrumentat që mund të përdoren për trajtimin e kësaj zone. Dhe në këtë rast, duhet që nismën ta marrë një institucion kompetent dhe përsa i përket vlerave të trashëgimisë kulturore të zonës, nuk është bashkia, por është Ministria e Kulturës.

Z.Beka, shprehet se ju lutem, nuk mund të zgjatemi pambarimisht në këtë temë, sepse njëherëit kanë nevojë të informohen . Këtu jemi për të mirën e të gjithëve, për të dhënë përgjigje për të gjithë.

Përsëri **Z.I.Sokoli** shprehet se është hera e parë që i thuhet publikut që ka një procedurë të tillë në Shkodër.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.

*Kryetari e Këshillit **Z.Luli** e deklaron mbledhjen të mbyllur.*

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 31.10.2025. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 19 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

V.o: Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e rradhës së Këshillit bashkiak.


Sekretar

Sabina DANAJ



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti



KRYETAR

Oltion LULI

